

II. JETA SHPIRTËRORE LA VITA SPIRITUALE



Onufri: Pagëzimi i Zotit Krisht

Onufrio: Battesimo di Nostro Signore



II. JETA SHPIRTËRORE

I krishteri rron dhe rritet në kishë, së cilës Zoti Krisht i la sakramentet, që njeriu me ato të mund të marrë pjesë në jetën e amshuar.

A. SAKRAMENTET

62. I riu: *Ç'janë sakramentet?*

Prifti: Sakramentet janë shenja të hirit, që realizojnë atë që simbolizojnë. Janë themeluar nga Jezu Krishti dhe me ato shenjtërohet i krishteri.

63. I riu: *Sa janë sakramentet?*

Prifti: Sakramentet janë shtatë.

64. I riu: *Cilat janë sakramentet?*

Prifti: Sakramentet janë:

Pagëzimi

Krezmimi (Miron)

Kungimi (Euharistia)

Rrëfimi (Ksomollojisja)

Martesa

Urdhëri i Shenjtë

Vaji i Shenjtë (Efqelia)

II. LA VITA SPIRITUALE

Il cristiano vive e cresce nella chiesa a cui Nostro Signore Gesù Cristo ha lasciato i sacramenti, così che l'uomo, per mezzo di essi, possa partecipare alla vita eterna.

A. I SACRAMENTI

62. Il giovane: *Cosa sono i sacramenti?*

Il sacerdote: I sacramenti sono i segni della grazia; essi realizzano ciò che significano. Sono istituiti da Gesù Cristo e per mezzo di essi il cristiano è santificato.

63. Il giovane: *Quanti sono i sacramenti?*

Il sacerdote: I sacramenti sono sette.

64. Il giovane: *Quali sono i sacramenti?*

Il sacerdote: I sacramenti sono:

Battesimo

Cresima

Eucarestia

Penitenza

Matrimonio

Ordine sacro

Olio santo

65. I riu: Ç'është pagëzimi?

Prifti: Pagëzimi është i pari sakrament; me atë njeriu bëhet i krishterë.

Pagëzimi e lan njeriun nga mëkati i Adamit dhe i Evës, nga mëkati i stërgjyshërve. Me anë të pagëzimit njeriu bashkohet me trupin e Krishtit dhe bëhet pjesëtar i kishës. Njeriu rilindet.

66. I riu: Si bëhet pagëzimi?

Prifti: Prifti e pyet atë që do të pagëzohet nëse e njeh besën e krishterë. Shpallet « *krëdoja* ». Nëse ai që pagëzohet është i vogël, përgjigjet nuni dhe nuna.

Këtu prifti bekon ujin.

Pastaj merr atë që do të pagëzohet, i cili është i zhveshur dhe e fut për tri herë brenda në ujë duke thënë: « Shërbëtori o shërbëtorja i (e) Perëndisë - *këtu thuhet emri* - pagëzohet në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë ». Pastaj i pagëzuari vishet me një rrobë të re, të bardhë, dhe prifti thotë: « Shërbëtori ose shërbëtorja i (e) Perëndisë - *thuhet emri* - vesh rrobën e drejtësisë ».

67. I riu: Pse prifti e fut tri herë brenda në ujë?

Prifti: Kujtohet se Zoti Krisht ka qenë tri ditë në varr dhe pastaj u ngjall.

Kështu njeriu në pagëzim u vdes mëkateve dhe ringjallet për një jetë të re. Prandaj të

65. Il giovane: Cosa è il battesimo?

Il sacerdote: Il battesimo è il primo sacramento. Per mezzo di esso l'uomo diventa cristiano. Il battesimo lava l'uomo dal peccato di Adamo e di Eva, dal peccato originale. Con il battesimo l'uomo viene incorporato a Cristo e diventa membro della chiesa. L'uomo viene rigenerato.

66. Il giovane: Come si celebra il battesimo?

Il sacerdote: Il sacerdote interroga il battezzando sulla sua conoscenza della fede cristiana. Quindi si proclama il *Credo*. Se il battezzando è un fanciullo, rispondono il padrino e la madrina. A questo punto il sacerdote benedice l'acqua. Quindi prende il battezzando che è stato completamente svestito e lo immerge per tre volte nell'acqua dicendo: « Il servo, o la serva, di Dio - *qui si pronuncia il nome* - è battezzato nel nome del Padre, del Figlio e dello Spirito Santo ».

Poi il battezzato viene rivestito di una veste nuova, bianca, mentre il sacerdote proclama: « Il servo, o la serva di Dio - *si ripete il nome* - riveste la veste di giustizia ».

67. Il giovane: Perché il sacerdote lo immerge per tre volte nell'acqua?

Il sacerdote: Si ricorda che il Signore Gesù Cristo è stato per tre giorni nel sepolcro e poi è risorto. Così il cristiano nel battesimo muore al peccato e risorge in novità di vita.

porsapagëzuarit i vishet një rrobë simbolike e re dhe e bardhë.

68. I riu: *A mundet dikush të pagëzohet dy herë?*

Prifti: Jo. S'mundet. Ashtu si njeriu lind vetëm një herë, kështu edhe në pagëzim i krishteri lind si njeri i ri vetëm një herë përgjithmonë. Pagëzimi i vulos njeriut një karakter që nuk shlyhet kurrë.

Ndalohet të përsëritet edhe pagëzimi i celebruar në mënyrë të vlefshme në kishat e tjera, domethënë në kishat ortodokse dhe protestante.

69. I riu: *Kështu pagëzimi i bashkon të gjithë të krishterët?*

Prifti: Pagëzimi është sakramenti që i bashkon të gjithë të krishterët në familjen e Zotit Krisht.

Per questo al battezzato si dà simbolicamente una veste nuova e bianca.

68. Il giovane: *Può uno essere battezzato due volte?*

Il sacerdote: No. Non è possibile. Come l'uomo nasce una sola volta, così nel battesimo il cristiano nasce, quale uomo nuovo, solo una volta per sempre. Il battesimo imprime sull'uomo un carattere indelebile.

Non si può ripetere neanche il battesimo validamente amministrato nelle altre chiese, cioè nelle chiese ortodosse e nelle comunità protestanti.

69. Il giovane: *In tal modo il battesimo unisce tutti i cristiani?*

Il sacerdote: Il battesimo è il sacramento che unisce tutti i cristiani nella famiglia di Nostro Signore Gesù Cristo.

70. **I riu:** *Ç'është krezmimi?*

Prifti: Është sakramenti me të cilin të pagëzuarit i jepet shenja e dhuratës së Shpirtit të Shenjtë, i cili e përforcon në besë dhe i jep ndihmën që të jetë dëshmitar i Krishtit përpara njerëzve.

71. **I riu:** *Si bëhet krezmimi?*

Prifti: Sapo i jepet të pagëzuarit rroba e re, prifti thotë një lutje me të cilën i lyp t'Ynë Zotit të dërgojë mbi të pagëzuarin Shpirtin e Shenjtë. Pastaj merr miron, vajin e shenjtë të bekuar nga peshkopi, dhe me atë i bën të pagëzuarit një shenjë kryqi në ballë, në sy, në hundë, në buzë, në veshë, në gji, në duar dhe në këmbë. Nganjëherë thotë: «Shenjë e dhuratës së Shpirtit të Shenjtë».

72. **I riu:** *Pse e lyen kështu?*

Prifti: Të lyerit me vaj simbolizon shpirtin e Shenjtë, që frymëzon tërë jetën e të krishterit.

I lyhet balli që të kuptojë besën, sytë që të shohë të vërtetën, hunda që të marrë erën e veprave të mira, buzët që të flasë me urtësi, veshët që të dëgjojë fjalën e t'Ynë Zotit, gjirin që të ketë zemër të pastër, duart që të bëjë vepra të mira, këmbët që të ecë në udhën e drejtë.

70. **Il giovane:** *Cosa è la cresima?*

Il sacerdote: È il sacramento con cui al battezzato viene elargito il sigillo del dono dello Spirito Santo, il quale lo conferma nella fede e lo abilita a essere testimone di Cristo di fronte agli uomini.

71. **Il giovane:** *Come si celebra la cresima?*

Il sacerdote: Non appena il battezzato è stato rivestito con la veste nuova, il sacerdote recita la preghiera con la quale chiede al Signore di inviare lo Spirito Santo. Quindi prende il myron, olio santo consacrato dal vescovo, e con esso fa sul battezzato un segno di croce sulla fronte, sugli occhi, sulle narici, sulle labbra, sulle orecchie, sul petto, sulle mani e sui piedi. Ciascuna volta dice: «Sigillo del dono dello Spirito Santo».

72. **Il giovane:** *Perché si fanno queste unzioni?*

Il sacerdote: L'unzione con olio simboleggia lo Spirito Santo che ispira l'intera vita del cristiano. Si fa l'unzione sulla fronte perché il cristiano comprenda la fede, sugli occhi perché veda la verità, sulle narici perché prenda odore dalle opere buone, sulle labbra perché parli con sapienza, sulle orecchie perché ascolti la Parola di Dio, sul petto perché abbia un cuore puro, sulle mani perché faccia opere buone, sui piedi perché cammini sulla retta via.

73. I riu: *Pse e shenjtëron miron peshkopi?*

Prifti: Ky fakt simbolizon bashkimin dhe njësinë e kishës lokale. Të gjithë të krishterët e atij vendi janë të lyer me një vaj. Të gjithë bëjnë pjesë në atë kishë që është tek ai vend dhe varet nga një peshkop.

74. I riu: *Kur mund të marrë pjesë në kungim ai që është i krezmuar?*

Prifti: Sapo dikush krezmohet, mund të marrë pjesë në kungim.

Kanuni i ri i kishës lindore katolike thotë se të porsapagëzuarve dhe të krezmuarve duhet t'u jepet kungimi *sa më shpejt*.

Edhe të vegjëlit duhen të marrin pjesë në kungim.

Jo vetëm ditën e pagëzimit, por çdo të diel dhe çdo festë. Kështu, të gjithë bashkë, prindër dhe fëmijë, kungohen me kurmin dhe gjakun e Zotit Krisht. E tërë familja rritet me ndihmën e t'Ynë Zoti.

73. Il giovane: *Perché il myron viene consacrato dal vescovo?*

Il sacerdote: Ciò simboleggia la comunione e l'unità della chiesa locale. Tutti i cristiani di un dato luogo sono unti con un unico olio. Tutti fanno parte di quella chiesa di quel determinato luogo e dipendono da un vescovo.

74. Il giovane: *Appena cresimato, uno può partecipare all'eucarestia?*

Il sacerdote: Il cresimato, subito dopo la cresima, può partecipare all'eucarestia.


Il nuovo codice dei canoni delle chiese orientali cattoliche afferma che, dopo il battesimo e la cresima, bisogna amministrare, *quanto prima* ai cristiani, anche l'eucarestia.

Anche i fanciulli devono prendere parte alla comunione.

E ciò non soltanto il giorno del battesimo, ma così ogni domenica e ogni festa. In tal modo tutti insieme, genitori e figli, partecipano al corpo e al sangue di Cristo. L'intera famiglia cresce con l'aiuto del Signore.



Paraqitja në Tempull e Zotit Krisht
Presentazione al Tempio di Gesù Cristo



Darka e fundit e Zotit Krisht
Ultima cena di Nostro Signore

75. I riu: *Ç'është euharistia ose kungimi?*

Prifti: Euharistia është sakramenti që, nën dukjen e bukës dhe të verës, përmban në të vërtetë kurmin e gjakun e Zotit Krisht. Në euharistinë kisha i paraqet Atit flijimin e pagjakshëm lavdëror dhe në atë të krishterët kungohen me kurmin dhe me gjakun e Jezu Krishtit.

76. I riu: *Si mund të ndodhë kjo?*

Prifti: Është mister i madh i besës së krishterë.

Kur Jezu Krishti hëngri herën e fundit me apostujt, mori bukën, e bekoi, e ndau, ua dha nxënësve e tha: « Merrni, hani, ky është kurmi im ». Pastaj mori qelqin e verës, bëri lutjen e falënderimit, ua dha atyre e tha: « Pini prej këtij të gjithë, ky është gjaku im i Besëlidhjes së re, që do të derdhet për ju dhe për shumë, për ndjesë të mëkateve ». Pastaj Zoti Krisht dha këtë urdhërim të ri: « Bëjeni këtë në përkujtimin tim ».

Prifti, në celebrimin e çdo liturgjie euharistike, bën si tha Ynë Zot dhe i lutet Atit që të dërgojë Shpirtin e Tij për të shndërruar dhuratat e shenjta. Kështu me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, gjatë meshës realizohet ky mister i madh: buka e vera me të vërtetë shndërrohen në kurmin e gjakun e Zotit Krisht.

Euharistia është përkujtimi i vdekjes dhe i ringjalljes së Krishtit. Në të aktualizohet

75. Il giovane: *Cosa è l'eucarestia?*

Il sacerdote: L'eucarestia è il sacramento nel quale, sotto le specie del pane e del vino, si trovano veramente il corpo e il sangue di Nostro Signore Gesù Cristo. Nell'eucarestia la chiesa offre al Padre il sacrificio incruento di lode e i cristiani si comunicano al corpo e al sangue di Gesù Cristo.

76. Il giovane: *Come è possibile questo?*

Il sacerdote: È un grande mistero della fede cristiana.

Quando Gesù Cristo consumò per l'ultima volta la cena con gli apostoli, prese il pane, lo benedisse, lo spezzò e lo diede ai discepoli dicendo: « Prendete e mangiate, questo è il mio corpo ». Poi prese il bicchiere con il vino, fece la preghiera di ringraziamento, e lo diede loro dicendo: « Bevetene tutti, questo è il sangue del Nuovo Testamento, che viene sparso per la moltitudine, in remissione dei peccati ». Alla fine Gesù Cristo ha dato questo comandamento: « Fate questo in memoria di me ». Il sacerdote in ogni celebrazione eucaristica fa quanto ha comandato il Signore e invoca il Padre che invii il suo Spirito per la trasformazione dei santi doni. E per la potenza dello Spirito Santo, durante la celebrazione, si realizza questo grande mistero: il pane e il vino vengono trasformati in corpo e sangue di Nostro Signore Gesù Cristo.

flijimi i kryqit. Në euharistinë edhe ne i kushtojmë Atit një therore lavdërimi, të pagjakshme dhe shpirtërore.

Është kështu që kur i krishteri kungohet, merr pjesë në kurmin e gjakun e Zotit Krisht. Për këtë duhet besë, frikë Perëndie e dashuri, kur qasemi te tryeza e she-njtë.

77. I riu: *Ç'i nevojitet njeriut për t'u kunguar?*

Prifti: Duhet të jetë i pagëzuar dhe i krez-muar dhe të mos ketë mëkate të rënda mbi zemër. Në qoftë se dikush ka bërë mëkate të rënda duhet të rrëfëhet para se të kungohet. Çdo herë që dikush vete në meshë është mirë të kungohet.

78. I riu: *Pse është mirë të kungohemi?*

Prifti: Kungimi me kurmin dhe me gjakun e t'Ynë Zoti na jep jetën e pasosur. Tha Ynë Zot: « Ai që ha kurmin tim dhe pi gjakun tim e ka jetën e pasosur. Unë atë do ta ringjall në ditën e fundit » (Joan. 6,54).

79. I riu: *Mesha lëtire ndryshon nga mesha jonë bizantine?*

Prifti: Euharistia është e njëjtë. Si ajo lëtire, si ajo bizantine bëjnë të njëjtin përkujtim të vdekjes dhe të ringjalljes së Krishtit. Vetëm format liturgjike ndryshojnë.

Pertanto l'eucarestia è il memoriale della morte e della resurrezione di Gesù Cristo. In essa viene attualizzato il sacrificio della croce e con essa anche noi offriamo il sacrificio di lode, incruento e spirituale. Quando il cristiano si comunica, partecipa al corpo e al sangue di Gesù Cristo. Per questo si richiede fede, timore di Dio e amore, quando ci accostiamo alla santa tavola.

77. Il giovane: *Cosa si richiede perché si possa partecipare all'eucarestia?*

Il sacerdote: Bisogna che sia battezzato e cresimato e che non sia in stato di peccato grave. Se uno ha commesso peccati gravi, si richiede che si confessi prima di accedere alla comunione. Normalmente ogni volta che uno partecipa alla liturgia eucaristica, si dovrebbe anche comunicare.

78. Il giovane: *A che giova accostarsi alla comunione?*

Il sacerdote: La partecipazione al corpo e al sangue di Nostro Signore ci dà la vita eterna. Ha detto il Signore: « Chi mangia la mia carne e beve il mio sangue ha la vita eterna. Ed io lo risusciterò nell'ultimo giorno » (Gv. 6,54).

79. Il giovane: *La messa latina differisce dalla nostra liturgia bizantina?*

Il sacerdote: L'eucarestia è identica. Tanto quella latina quanto quella bizantina fanno l'unico memoriale della morte e della resurrezione di Cristo. Soltanto la forma liturgica differenzia l'una dall'altra.

80. I riu: *Ç'është ksomollojisa o rrëfimi?*

Prifti: Eshtë sakramenti i themeluar nga Zoti Krisht për ndjesën e mëkateve të bëra pas pagëzimit.
Me atë bëjmë paqe me Zotin nëpërmjet kishës.

81. I riu: *Ç'i nevojitet të krishterit për t'u rrëfyer si duhet?*

Prifti: Për t'u rrëfyer është e nevojshme:

- a) të kujtojmë gjithë mëkatet e bëra;
- b) t'ia rrëfejme priftit;
- c) të pendohemi;
- d) të premtojmë se s'do t'i bëjmë më.

82. I riu: *Pse duhet t'ia themi priftit mëkatet tona?*

Prifti: Sikurse Zoti Krisht ua dha pushtetin dishepujve që këta të ndjejnë mëkatet, kështu ia jep çdo prifti. Meshtari ka pushtetin të zgjidhë mëkatet. Krishti i ringjallur u tha dishepujve: «Sikurse Ati im më ka dërguar mua, ashtu edhe unë ju dërgoj ju»; pastaj fryu mbi ta dhe u tha: «Merrni Shpirtin e Shenjtë; atyre të cilëve ua ndjeni mëkatet, u janë ndjerë: atyre të cilëve ua mbani, u janë mbajtur» (Joan. 20,21-23).

83. I riu: *Si bëhet ksomollojisa ose rrëfimi?*

Prifti: Prifti qëndron përpara një ikone dhe vesh epitrahilin. Kjo do të thotë se prifti është i veshur me pushtetin që i dha

80. Il giovane: *Cosa è la penitenza?*

Il sacerdote: È il sacramento istituito da Nostro Signore Gesù Cristo per il perdono dei peccati commessi dopo il battesimo. In esso ci riconciliamo con il Signore attraverso la chiesa.

81. Il giovane: *Cosa si richiede al cristiano per una buona confessione?*

Il sacerdote: Per una buona confessione si richiede:

- a) ricordare tutti i peccati commessi
- b) confessarli al sacerdote
- c) essere pentiti
- d) promettere di non commetterli più.

82. Il giovane: *Perché bisogna confessare al sacerdote i propri peccati?*

Il sacerdote: Perché come Gesù Cristo ha dato agli apostoli il potere di rimettere i peccati, così lo dà ad ogni sacerdote. Questi ha il potere di rimettere i peccati. Il Cristo risorto ha detto ai discepoli: «Come il Padre ha mandato me, anch'io mando voi». Poi alitò su di loro e disse: «Ricevete lo Spirito Santo, a chi rimetterete i peccati saranno rimessi, e a chi non li rimetterete, non saranno rimessi» (Gv. 20, 21-23).

83. Il giovane: *Come si celebra la penitenza?*

Il sacerdote: Il sacerdote si porta dinnanzi ad una icona e indossa l'epitrahilion, la stola. Ciò significa che il sacerdote è

Ynë Zot, dhe se vetëm Ynë Zot i ndjen mëkatet e njeriut. Përpara priftit sillet i krishteri. Bashkë thonë lutjet. Pastaj i krishteri rrëfen gjithë mëkatet që ka bërë dhe lyp ndjesën. Prifti i jep këshillat e duhura. Pastaj i bën lutjen t'Ynë Zoti, me të cilën lyp të ndjejë mëkatet e rrëfyera dhe bekon të krishterin.

Pastaj prifti i vë pendestarit si detyrë të bëjë disa vepra të mira në mënyrë që i krishteri të kujtohet se s'duhet të bjerë më në mëkat. Këto vepra mund të jenë disa lutje, ndonjë ditë agjërimi, ndonjë ndihmë për njeriun që ka nevojë.

Pastaj tek e para meshë i krishteri kungohet, i pajtuar me t'Ynë Zot dhe me kishën.

rivestito del potere datogli dal Signore e che solo il Signore rimette i peccati dell'uomo. Il fedele si reca di fronte al sacerdote. Insieme recitano le preghiere stabilite. Quindi il fedele confessa tutti i peccati commessi e chiede perdono. Il sacerdote dà i consigli opportuni. Poi fa la preghiera al Signore con cui chiede di rimettere i peccati confessati e assolve il fedele.

Quale penitenza il sacerdote indica alcune opere buone da compiere, in modo che il fedele si corregga e non cada più in peccato. Queste buone opere possono essere: delle preghiere, qualche giorno di digiuno, un aiuto a qualcuno che è nel bisogno. Poi alla prima celebrazione eucaristica il cristiano si comunica riconciliato con il Signore e con la chiesa.

84. **I riu:** *Ç'është martesë?*

Prifti: Është sakramenti që bashkon, në dashurinë e tyre, burrin e gruan në mënyrë të pazgjidhshme, u jep hirin dhe ndihmën e t'Ynë Zotit që të shkojnë bashkë një jetë të shenjtë, që të kenë fëmijë dhe t'i rritin në rrugën e Krishtit.

85. **I riu:** *Pse dy veta martohen?*

Prifti: Dy veta martohen pse duhen mirë dhe duan të formojnë një familje të re.

86. **I riu:** *Si bëhet martesë?*

Prifti: Kur marrin fund të gjitha përgatitjet, ata që do të vënë kurorë, venë në kishë, ku i pret prifti.

Ky, te dera, i pyet nëse duan të martohen. Pastaj prifti celebron ritin e shkëlqisë, e fesës. Thotë lutjet e duhura dhe bekon unazat, që pastaj ua vë në gisht dhëndrit dhe nuses. Kumbari ua shkëmben. Kështu ata premtojnë se do të lidhen me martesë përgjithmonë.

Pastaj të gjithë shkojnë në qendër të kishës duke kënduar psallmin 127. Këtu bëhet liturgjia e martesës. Prifti bekon kurorat. Pastaj ia vë njërën dhëndrit mbi krye dhe tjetrën nuses. Duke i bekuar thotë: «Ti, o Zot, ti o Perëndi, vëru kurorë me nder e me lavdi». Pastaj lexohet një pjesë nga Letra e Shën Palit të krishterëve të Efesit (5,20-25) dhe një pjesë nga Vangjeli i Shën Joanit (2,1-11) ku flitet për martesën në

84. **Il giovane:** *Cosa è il matrimonio?*

Il sacerdote: È il sacramento che unisce, nel loro amore, l'uomo e la donna in modo indissolubile, dà loro la grazia e l'aiuto del Signore perché insieme vivano una vita santa, generino figli e li facciano crescere sulla via di Cristo.

85. **Il giovane:** *Perché due persone si sposano?*

Il sacerdote: Due persone si sposano perché si amano e intendono formare una nuova famiglia.

86. **Il giovane:** *Come si celebra il matrimonio?*

Il sacerdote: Al termine di tutte le necessarie preparazioni, i due che vogliono contrarre matrimonio si recano in chiesa, dove li attende il sacerdote. Questi, sulla porta, chiede loro se vogliono sposarsi. Quindi il prete fa il rito del fidanzamento. Recita le preghiere previste e benedice gli anelli e ne pone uno al dito dello sposo e l'altro della sposa. Il compare li scambia. Così essi promettono di unirsi in matrimonio per sempre. In seguito tutti si portano al centro della chiesa mentre si canta il salmo 127.

Qui ha luogo la liturgia del matrimonio. Il sacerdote benedice le corone. Ne pone una sul capo dello sposo e l'altra sul capo della sposa. Nel benedirli dice: «Tu, o Signore, Dio nostro, incoronali di onore e di gloria». Viene proclamata quindi una pericope della lettera di S. Paolo agli Efesini (5,20-25)

Kanë të Galilesë në të cilën mori pjesë Jezu Krishti me dishepujt e me Shën Mërinë. Pas disa lutjeve prifti bekon një qelq me verë dhe, si simbol bashkimi, ua jep ta pinë vetëm dhëndrit dhe nuses dhe pastaj e thyen.

Pastaj prifti bashkë me ata që u martuan dhe me dëshmitarët, duke kënduar, bëjnë tri rrathë në mes të kishës si një valle hareje. Vallja në rrathë simbolizon jetën e pasosur, e cila nuk mbaron kurrë.

Pastaj prifti i heq kurorat nga kryet e dhëndrit dhe e nuses dhe i bekon të dy që të kenë jetë të gjatë dhe të lumtur.

87. I riu: *Prandaj kur dy njerëz martohen thuhet se vënë kurorë?*

Prifti: Në traditën bizantine kurorat janë simboli i martesës.

88. I riu: *Ka nga ata që nuk martohen në kishë?*

Prifti: Për kishën katolike dhe për kishën ortodokse është sakrament vetëm martesja e celebruar sipas rregullave të kishës.

89 I riu: *Disa pastaj ndahen. Kisha katolike e njeh divorcin ose shkurorëzimin?*

Prifti: Kisha katolike nuk e njeh divorcin. Ata që martohen sipas rregullave të kishës nuk mund të ndahen më. Tha Ynë Zot:

e il brano dal Vangelo di S. Giovanni (2,1-11) dove si parla del matrimonio in Cana di Galilea, al quale è stato presente Gesù Cristo assieme a sua Madre e ai discepoli. Recitate alcune preghiere, il sacerdote benedice un bicchiere di vino e, quale simbolo di comunione, lo offre da bere esclusivamente allo sposo e alla sposa e quindi lo rompe.

Poi il sacerdote, assieme agli sposi e ai testimoni, cantando, fa tre giri al centro della chiesa come una danza di gioia. La danza circolare è simbolo della vita senza fine, che non termina mai. Infine il sacerdote toglie le corone dal capo dello sposo e della sposa e li benedice perché abbiano vita lunga e felice.

87. Il giovane: *E' per questo che quando due persone si sposano, noi albanesi diciamo che « si incoronano »?*

Il sacerdote: Nella tradizione bizantina le corone sono il simbolo del matrimonio.

88. Il giovane: *Vi sono alcuni che non si sposano in chiesa.*

Il sacerdote: Per la chiesa cattolica e per la chiesa ortodossa è sacramento soltanto il matrimonio celebrato secondo le regole della chiesa.

89. Il giovane: *Alcuni poi si separano. La chiesa cattolica riconosce il divorzio?*

Il sacerdote: La chiesa cattolica non riconosce il divorzio. Due che si sono uniti in matrimonio, secondo le regole della chiesa, non si possono più dividere. Ha detto

« Të mos ndajë njeriu atë që Ynë Zot bashkoi » (Mt. 19,6).

90. I riu: *U lejohet katolikëve të martohen me anëtarë të kishave të tjera, ortodokse dhe protestante?*

Prifti: Martesa është një bashkim shpirtëror i thellë. Njësia e besës e ndihmon patjetër këtë bashkim.

Por kisha lejon që katolikët - që e lypin - të martohen me anëtarë të kishave të tjera, ortodokse dhe protestante. Për këtë është e nevojshme leja e peshkopit. Dhe për të marrë këtë lejë, pjesa katolike e martesës duhet të premtojë se do të bëjë ç'është e mundur për të pagëzuar dhe për të edukuar fëmijët në kishën katolike.

Edhe në këto raste, pagëzimi i përbashkët i prindërve dhe besa e tyre në Krishtin jep mjetet për një edukim siç duhet të fëmijëve në besën e krishterë.

91. I riu: *A u lejohet katolikëve të martohen me besimtarë jo të krishterë, si, për shembull, me muhamedanë?*

Prifti: Po. Me lejën e peshkopit këto martesë janë të mundshme. Kjo lejë është e domosdoshme. Në këto martesë, vështirësitë për bashkimin shpirtëror janë më të mëdha dhe duhet një vëmendje e madhe.

il Signore: « Non separi l'uomo ciò che Dio ha unito » (Mt. 19,6).

90. Il giovane: *È permesso ai cattolici di contrarre matrimonio con membri delle altre chiese, ortodosse e protestanti?*

Il sacerdote: Il matrimonio costituisce una unione spirituale profonda. L'unità nella fede certamente favorisce questa unione. Ma la chiesa ammette che i cattolici - quando lo vogliono - possono contrarre matrimonio con membri delle altre chiese, ortodosse e protestanti. Per questo si richiede però il permesso del vescovo. Inoltre la parte cattolica deve impegnarsi a fare il possibile per battezzare ed educare i figli nella chiesa cattolica.

Anche in questi casi il battesimo comune dei genitori cristiani e la loro fede in Gesù Cristo offrono loro i mezzi perché educino, come si deve, i figli nella fede cristiana.

91. Il giovane: *È permesso ai cattolici di contrarre matrimonio con credenti non cristiani, per esempio con musulmani?*

Il sacerdote: Sì. Col permesso del vescovo, è possibile. Questo permesso è necessario. Ma le difficoltà di unione spirituale - in questi casi - sono maggiori e si richiede grande attenzione.

92. I riu: *Ç'është urdhri i shenjtë?*

Prifti: Eshtë sakramenti i themeluar nga Zoti Krisht, në të cilin, me dorëzimin e peshkopit dhe me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, shugurohen ministrat e kishës dhe i jepet, kujtdo si i duhet, pushteti për të predikuar, për të shenjtëruar dhe për të drejtuar popullin e t'Ynë Zoti.

93. I riu: *Si është i organizuar urdhri i shenjtë?*

Prifti: Në urdhrin e shenjtë janë tri shkallë: dhjakonati, priftëria dhe peshkopata.

94. I riu: *Ç'mund të bëjë dhjaku?*

Prifti: Dhjaku ka vendin e tij në çdo liturgji. Kur thuhet mesha ai lexon Vangjelin dhe drejton lutjen e popullit. Dhjaku mund të organizojë katekizmin dhe mund të predikojë edhe gjatë meshës. Por dhjaku s'mund të thotë meshën, s'mund të rrëfejë dhe s'mund të celebrojë martesat. Që të mund ta bëjë këtë, duhet të jetë i shuguruar prift.

95. I riu: *Ç'mund të bëjë prifti?*

Prifti: Prifti është ministri i Zotit Krisht në një vend. Me shugurimin i jepet pushteti që të predikojë dhe të celebrojë sakra-

92. Il giovane: *Cosa è l'ordine sacro?*

Il sacerdote: È il sacramento istituito da Nostro Signore Gesù Cristo, nel quale, per mezzo dell'imposizione delle mani del vescovo e con la potenza dello Spirito Santo, vengono ordinati i ministri della chiesa e viene dato, a ciascuno, nel grado che si richiede, il potere di predicare, di santificare e di reggere il popolo di Dio.

93. Il giovane: *Come è strutturato l'ordine sacro?*

Il sacerdote: Nell'ordine sacro ci sono tre gradi: il diaconato, il presbiterato e l'episcopato.

94. Il giovane: *Quali sono le funzioni del diacono?*

Il sacerdote: Il diacono ha il proprio posto in ogni liturgia. Quando si celebra la liturgia egli proclama il Vangelo e dirige la preghiera del popolo.

Il diacono può organizzare la catechesi e anche predicare durante la liturgia. Ma non può celebrare l'eucarestia, non può confessare, non può celebrare il matrimonio. Perché possa fare queste cose, deve essere ordinato sacerdote.

95. Il giovane: *Cosa può fare il sacerdote o presbitero?*

Il sacerdote: Il sacerdote è il ministro di Nostro Signore Gesù Cristo. Con l'ordinazione gli viene dato il potere di predicare

mentet, por ai s'mund të shugurojë priftërinj të tjerë. Ai celebron euharistinë e shenjtë dhe ndjen mëkatet nëpërmjet rrëfimit.

96. I Riu: *Ç'mund të bëjë peshkopi?*

Prifti: Peshkopi mund të bëjë të gjitha ato vepra që bën prifti. Veç atyre ai mund të shugurojë të tjerë peshkopë, priftërinj dhe dhjakë. Vetëm peshkopi mund të bëjë këtë në kishë.

Peshkopët janë pasardhësit e apostujve.

97. I riu: *Ç'vepra të tjera mund të bëjë peshkopi?*

Prifti: Peshkopi është kryetari i eparhisë ose ipeshkvisë, ai që në emër të Krishtit e mban këtë të bashkuar dhe të organizuar. Ai drejton priftërinjtë, dhjakët dhe laikët.

Ai bën pjesë në kolegjin e të gjithë peshkopëve të kishës katolike. Kur mbahet një koncil ekumenik, ai merr pjesë në të. Vetëm peshkopët mund të marrin pjesë në koncilin ekumenik.

98. I riu: *Ç'është koncili ekumenik?*

Prifti: Koncili ekumenik është mbledhja zyrtare dhe solemne e peshkopëve të botës së tërë (në greqishten: *oikoumene*) për të caktuar çështjet e besës së krishterë, të moralit dhe të disiplinës. Koncili mblidhet vetëm për çështjet më të rëndësishme të kishës së Krishtit.

99. I riu: *Ç'është Papa?*

Prifti: Papa është peshkopi i Romës. Si të gjithë peshkopët, ai është pasardhës i apo-

e di celebrare i sacramenti, ad eccezione di quello di ordinare altri sacerdoti e diaconi. Egli celebra la santa eucarestia e rimette i peccati nel sacramento della penitenza.

96. Il giovane: *Cosa può fare il vescovo?*

Il sacerdote: Il vescovo può fare tutto ciò che fa un sacerdote. Inoltre egli può ordinare altri vescovi, sacerdoti, diaconi. Solo il vescovo può fare ciò nella chiesa.

I vescovi sono i successori degli apostoli.

97. Il giovane: *Quali altre funzioni può svolgere il vescovo?*

Il sacerdote: Il vescovo è il capo di una eparchia; egli in nome di Cristo la mantiene unita e organizzata. Egli dirige i sacerdoti, i diaconi e i laici.

Egli fa parte del collegio episcopale della chiesa cattolica. Quando si celebra un concilio ecumenico, egli vi partecipa. Solo i vescovi possono prendere parte al concilio ecumenico.

98. Il giovane: *Cosa è il concilio ecumenico?*

Il sacerdote: È l'assemblea ufficiale e solenne dei vescovi del mondo intero (in greco: *oikoumene*) per definire le questioni spettanti alla fede, alla morale e alla disciplina. Il concilio si riunisce soltanto per le questioni più importanti della chiesa di Cristo.

99. Il giovane: *Chi è il Papa?*

Il sacerdote: Il Papa è il vescovo di Roma. Come tutti i vescovi egli è successore degli

stujve. Por Papa është pasardhësi i Shën Pjetrit, të cilit Ynë Zot i ka dhënë një pushtet dhe një rol të veçantë. Si pasardhës i Shën Pjetrit, Papa e trashëgon atë rol dhe atë pushtet. Ai është i pari peshkop i kishës katolike dhe kryetari i kolegjit të peshkopëve. Ai ka një pushtet të veçantë që në kishën e Krishtit nuk e ka asnjë peshkop tjetër.

Vetëm Papa mund të thërresë të gjithë peshkopët e kishës katolike për një koncil të përgjithshëm a ekumenik. Kështu të gjithë peshkopët bashkë me Papën formojnë kolegjin që drejton jetën e kishës katolike.

100. I riu: *A mund të bëjë Papa gabime?*

Prifti: Po. Si çdo njeri edhe Papa mund të bëjë gabime. Por ai nuk mund të bëjë asnjë gabim kur shpall besën e kishës. Kisha katolike deklaroi në Koncilin e parë të Vatikanit (1870), se Papa s'mund të bëjë gabime kur në mënyrë zyrtare dhe solemne mëson besën e krishterë.

Shpirti i Shenjtë e ruan në të vërtetën.

101. I riu: *Në kishën arbëreshe ka priftërinj të martuar?*

Prifti: Në kishën arbëreshe, si në të tjerat kisha lindore katolike dhe në kishat ortodokse, është e mundur të shugurohen dhjakë dhe priftërinj burra të martuar. Por nuk lejohet që një njeri i cili është shuguruar dhjak ose prift, të martohet.

Kodiku i ri i kanuneve të kishave lindore katolike e ripohon këtë traditë të lashtë.

apostoli. Ma il Papa è successore di San Pietro, a cui nostro Signore ha dato un potere e un ruolo particolari. Quale successore di S. Pietro, il Papa riceve quel ruolo e quel potere. Egli è il primo dei vescovi della chiesa cattolica e il capo del collegio episcopale. Egli ha un potere particolare che nella chiesa di Cristo non ha nessun altro vescovo. Soltanto il Papa può convocare tutti i vescovi della chiesa cattolica per un concilio generale o ecumenico. In tal modo tutti i vescovi assieme al Papa formano il collegio che dirige la vita della chiesa cattolica.

100. Il giovane: *Può il Papa commettere errori?*

Il sacerdote: Sì. Come ogni persona umana il Papa può commettere errori. Però non può commettere alcun errore quando proclama la fede della chiesa. La chiesa cattolica ha definito nel Concilio Vaticano I (1870) che il Papa è infallibile quando insegna in modo ufficiale e solenne la fede cristiana.

Lo Spirito Santo lo salvaguarda nella verità.

101. Il giovane: *Nella chiesa arbëreshe sono ammessi i preti sposati?*

Il sacerdote: Nella chiesa arbëreshe, come nelle altre chiese orientali cattoliche e nelle chiese ortodosse, è possibile ordinare al diaconato e al presbiterato uomini sposati. Non è permesso però che uno già ordinato diacono o presbitero possa sposarsi.

Il nuovo Codice dei canoni delle chiese orientali cattoliche conferma questa antica

Por peshkopët zgjidhen në mes klerit të pamartuar.

102. I riu: *Eshtë e mundur të shugurohen gratë si priftërinj?*

Prifti: Si kisha katolike, ashtu edhe kishat ortodokse nuk e pranojnë mundësinë të shugurohen gra si priftërinj. As Zoti Krisht, as tradita e madhe e kishës kurrë nuk kanë shuguruar gra si priftërinj.

Por edhe gruaja duhet të luajë një rol pohor dhe aktiv në jetën e kishës: në predikimin, në mësimin e katekizmit, në liturgjinë, në strukturat dhe në veprimtarinë e kishës.

tradizione. I vescovi però vengono scelti fra il clero non sposato.

102. Il giovane: *È possibile ordinare al sacerdozio delle donne?*

Il sacerdote: La chiesa cattolica e la chiesa ortodossa non ammettono la possibilità di ordinare donne al sacerdozio, così come non ha fatto Gesù Cristo e la grande tradizione della chiesa.

Anche la donna però deve avere un ruolo attivo nella vita della chiesa: nella predicazione, nella catechesi, nella liturgia, nelle strutture e nelle attività della chiesa.

103. I riu: *Ç'është efqelia ose vaji i shenjtë?*

Prifti: Fjala «*efqeli*» është greke dhe do të thotë: «*lutje dhe vaj*». Është sakramenti i të sëmurëve.

Mbi të sëmurët prifti thotë lutje dhe i lyen me vaj të bekuar. Të sëmurëve të penduar ky sakrament u jep ndjesën e mëkateve dhe fuqi që të shërohen ose që të durojnë me paqe sëmundjen.

104. I riu: *Ku mbështetet në Shkrimet e Shenjta ky sakrament?*

Prifti: Vangjeli i Shën Markut na thotë se «*apostujt lyejnë me vaj shumë të sëmurë dhe i shërojnë*» (Mk. 6,13). Edhe Shën Japku shkruan: «*Është i sëmurë ndonjë ndër ju? Le të thërresë pleqtë e kishës, edhe le të falen përmbi atë, e le ta lyejnë me vaj në emrin e Zotit. Edhe urata që është me besë do t'a shpëtojë atë që lëngon, dhe Zoti do ta ngrejë atë, edhe në pastë bërë faqe, do t'i falen*» (Japku, 5,14-15).

105. I riu: *Si bëhet ky sakrament?*

Prifti: Kur dikush është i sëmurë thërret priftin. Në qoftë se mundet, i sëmuri vete në kishë, nëse jo, vjen prifti te shtëpia e të sëmurit.

Prifti bën lutjet e duhura, dhe bekon vajin e shenjtë. Pastaj me këtë vaj prifti e lyen të sëmurin mbi ballë, në hundë, në faqe, në gjoks, në duar, në këmbë dhe e bekon.

103. Il giovane: *Cosa è l'evchelaion o olio santo?*

Il sacerdote: Il termine *evchelaion* è greco e significa «*preghiera e olio*». È il sacramento degli ammalati.

Sugli ammalati il sacerdote recita una preghiera e li unge con olio benedetto. Agli ammalati pentiti questo sacramento rimette i peccati e dà la forza per guarire o per sopportare pazientemente la malattia.

104. Il giovane: *Dove si fonda nelle Sacre Scritture questo sacramento?*

Il sacerdote: Il Vangelo di S. Marco ci dice che «*gli apostoli ungevano con olio molti ammalati e li guarivano*» (Mc. 6,13). Anche S. Giacomo scrive: «*Chi è malato chiami a sé i presbiteri della chiesa e preghino su di lui dopo averlo unto con olio, nel nome del Signore. E la preghiera fatta con fede salverà il malato; il Signore lo rialzerà e se ha commesso peccati gli saranno perdonati*» (Gc. 5,14-15).

105. Il giovane: *Come si celebra questo sacramento?*

Il sacerdote: Quando qualcuno è ammalato chiama il sacerdote. Se l'ammalato può, egli stesso si reca in chiesa, altrimenti è il sacerdote che si reca nella sua casa. Il sacerdote recita le preghiere previste, e benedice l'olio santo. Quindi con quest'olio egli unge l'ammalato sulla fronte, sulle narici, sulle guance, sul petto, sulle mani, sui piedi e lo benedice.

Tradita bizantine parashikon që shtatë priftërinj celebroyjnë së bashku këtë sakrament. Por kur s'gjenden shtatë edhe një i vetëm mund ta bejë.

106. I riu: *A mund të celebrihet ky sakrament për shumë të sëmurë bashkë?*

Prifti: Po. Kur ka shumë të sëmurë, ata mund të mbledhen bashkë në kishë dhe prifti bën një lutje për të gjithë.

Në disa kisha kjo bëhet rregullisht të mërkurën e javës së madhe.

La tradizione bizantina prevede che siano sette sacerdoti a celebrare questo sacramento. Ma quando non se ne trovano sette, anche uno solo può farlo.

106. Il giovane: *Si può celebrare comunitariamente questo sacramento?*

Il sacerdote: Sì. Quando ci sono più ammalati, essi possono riunirsi in chiesa dove il sacerdote fa una celebrazione comune per tutti. In alcune chiese ciò si fa regolarmente il mercoledì della settimana santa.

107. I riu: *Pse liturgjia jonë quhet bizantine?*

Prifti: Pse ajo na vjen nga Bizanti o Kostantinopoja, qendra shpirtërore e kishës lindore.

Arbëreshët erdhën në shekullin XV në Itali, veçanërisht në Kalabri dhe në Sicili, nga Shqipëria e Jugut, ku besa e krishterë ishte predikuar nga misionarë grekë sipas traditës bizantine.

Kështu, kur arbëreshët erdhën në Itali, sollën bashkë me traditat e tjera edhe liturgjinë në ritin bizantin.

108. I riu: *Si është struktura e meshës bizantine?*

Prifti: Liturgjia që thuhet më shpesh në kishën bizantine është ajo e Shën Joan Hrysostomit.

Kjo meshë përbëhet nga tri pjesë:

a) *Përgatitja o proskomidija.*

Prifti bashkë me dhjakun, në altarin e vogël që është në anën e majtë të kishës, përgatit bukën dhe verën që do të vlejné për meshën.

b) *Liturgjia e Fjalës së t'Ynë Zoti.*

Kjo pjesë përmban këndimin e antifonave, disa pjesë psalmesh, leximin e Veprave dhe të Letrave të apostujve dhe të Vangjejeve. Pastaj prifti shpjegon Shkrimet e Shenjta dhe bën lutjet e katekumenëve, domethënë

107. Il giovane: *Perché la nostra liturgia si dice bizantina?*

Il sacerdote: Perché essa proviene da Bisanzio o Costantinopoli, il centro spirituale della chiesa orientale.

Gli arbëreshë sono emigrati nel secolo XV in Italia, particolarmente in Calabria e in Sicilia, dall'Albania del Sud dove la fede cristiana era stata annunciata da missionari greci, secondo la tradizione bizantina. Di conseguenza quando gli arbëreshë sono venuti in Italia, hanno portato assieme alle altre tradizioni, anche la liturgia nella forma bizantina.

108. Il giovane: *Quale è la struttura della messa bizantina?*

Il sacerdote: La liturgia che più spesso si celebra nella chiesa bizantina è quella di S. Giovanni Crisostomo.

Essa contiene tre parti:

a) *Preparazione o proskomidia*

Il celebrante insieme al diacono, su un piccolo altare collocato sulla sinistra del santuario, prepara il pane e il vino che saranno usati per la messa.

b) *Liturgia della Parola*

Questa parte contiene il canto delle antifone che sono alcuni versetti dei salmi; la proclamazione degli Atti e delle Lettere degli apostoli e la proclamazione dell'Evangelo.

In seguito il celebrante fa l'omelia sulle Sacre Scritture proclamate e recita la preghie-

të atyre që ende nuk janë pagëzuar dhe që po përgatiten për pagëzimin.

c) *Liturgia euharistike.*

Kjo pjesë përmban elementet qendrore të meshës: procesionin për të sjellë në altar bukën dhe verën, shenjën e paqes, shpalljen e besës së krishterë, anaforën, kungimin dhe bekimin e fundit.

109. I riu: Ç'është anafora?

Prifti: Është zemra e lirtugjisë euharistike. Dhjaku tërheq vëmendjen e të gjithëve duke thënë: « Le të rrimë me kujdes, le të rrimë me trëmbësi, le të vëmë re sa të kushtojmë në paqe theroren e shenjtë ». Në këtë pjesë prifti përkujton të gjitha veprat që bëri Ynë Zot për ne njerëzit. Nga mosqenia na solli në qenie dhe kur ramë në mëkat na ngriti lart përsëri. Për shpëtimin tonë dërgoi Zotin Krisht, i cili plotësoi gjithë veprën e shpëtimit për ne. Përpara se të vdiste, themeloi për ne të shenjtën euharisti për ndjesën e mëkateve dhe për jetën e pasosur të atyre që i kanë besë.

Prifti këndon edhe fjalët e Krishtit: « Merrni, hani, ky është kurmi im që çahet për ju për ndjesë të mëkateve... Pini prej këtij të gjithë, ky është gjaku i Testamentit të ri... ». Pastaj prifti bën lutjen e epiclesës dhe i lyp t'Ynë Zotit At: « Dërgo Shpirtin tënd të shenjtë... dhe bëje këtë bukë kurm të çmuar të Krishtit tënd, dhe atë që është në këtë qelq bëje gjak të çmuar të Krishtit tënd... duke i ndërruar me anën e Shpirtit tënd të Shenjtë ».

ra sui catecumeni, cioè su coloro che ancora non sono battezzati, ma che si preparano al battesimo.

c) *Liturgia eucaristica*

Questa parte comprende gli elementi centrali della messa: la processione per trasportare sull'altare il pane e il vino, il segno di pace, la professione di fede cristiana, l'anafora, la comunione e la benedizione finale.

109. Il giovane: Cosa è l'anafora?

Il sacerdote: È il cuore della liturgia eucaristica. Il diacono attira l'attenzione di tutti dicendo: « Stiamo con devozione, stiamo con timore attenti ad offrire in pace il santo sacrificio ». In questa parte il celebrante commemora tutta l'opera di salvezza compiuta dal Signore per gli uomini. Dal nulla ci ha portati all'esistenza e, caduti nel peccato, ci ha rialzati. Per la nostra salvezza Iddio ha inviato Nostro Signore Gesù Cristo, il quale ha compiuto per noi tutta l'economia di salvezza. Prima di morire ha istituito per noi la santa eucarestia per la remissione dei peccati e per la vita eterna dei credenti.

Il sacerdote proclama le parole di Cristo: « Prendete e mangiate, questo è il mio corpo che viene spezzato per voi in remissione dei peccati... Bevetene tutti, questo è il mio sangue del Nuovo Testamento... ».

Quindi il sacerdote recita la preghiera dell'epiclesi e chiede a Dio Padre: « Manda il tuo Spirito Santo e fa' di questo pane il prezioso corpo del tuo Cristo e di ciò che è in questo calice il prezioso sangue del

Gjatë celebrimit liturgjik, pas Fjalës së Zotit Krisht dhe me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, buka e vera bëhen kurrë e gjak të Krishtit.

Pas epiklesës prifti bën lutjen për të gjithë besimtarët e gjallë dhe të vdekur.

Pastaj të gjithë bashkë thonë lutjen «Ati Ynë» dhe pra ata që duan dhe janë të përgatitur marrin pjesë në kungim.

110. I riu: *Kungimi bëhet gjithmonë me bukë e verë?*

Prifti: Po. Në liturgjinë bizantine kungimi bëhet gjithmonë me bukë e verë, që jepen së bashku.

111. I riu: *Pse para anaforës shkëmbehet shenja e paqes?*

Prifti: Ky është një gjest shumë i vjetër në liturgjinë bizantine, dhe ka një simbolikë të madhe dhe shumë të bukur. Euharistia është sakramenti i paqësisë së njerëzve me t'Ynë Zot. Por Ynë Zot do edhe paqen e njerëzve si vëllezër.

Për këtë Zoti Krisht na tha: «Nëse gjendesh duke shtruar mbi altarin dhuratën tënde dhe aty kujtohesh se vëllai yt ka gjë kundër teje, lësho dhuratën tënde aty përpara altarit e shko më përpara të bësh paqe me vëllain tënd; pastaj kthehu dhe shtro dhuratën tënde» (Mt. 5,23-24).

tuo Cristo... trasmutandoli per virtù del tuo Spirito Santo ».

Durante la celebrazione liturgica, sulla Parola di Nostro Signore Gesù Cristo e per la potenza dello Spirito Santo, il pane e il vino si trasformano in corpo e sangue di Cristo. Conclusa l'epiclesi il sacerdote fa la preghiera di intercessione per tutti i fedeli vivi e defunti.

Poi, tutti i presenti insieme recitano la preghiera del «Padre nostro» e quindi, chi lo desidera ed è preparato, partecipa alla comunione.

110. Il giovane: *La comunione avviene sempre con il pane e il vino?*

Il sacerdote: Sì. Nella liturgia bizantina la comunione viene sempre distribuita sotto le due specie del pane e del vino date insieme.

111. Il giovane: *Perché prima dell'anafora si fa lo scambio di un segno di pace?*

Il sacerdote: È un gesto molto antico nella liturgia bizantina e contiene un grande simbolismo molto bello. L'eucarestia è il sacramento della pace fra l'uomo e Dio. Ma Nostro Signore vuole anche la pace fra gli uomini come tra fratelli. Per questo Gesù Cristo ci ha detto:

«Se dunque presenti la tua offerta sull'altare e lì ricordi che tuo fratello ha qualche cosa contro di te, lascia il tuo dono davanti all'altare e va' prima a riconciliarti con il tuo fratello e poi torna ad offrire il tuo dono» (Mt 5,23-24).

112. I riu: *Pse në fund të meshës shpërndahen di-
sa pjesë të bukës së bekuar?*

Prifti: Kjo bukë quhet « antidoron », është bukë vetëm e bekuar. Nuk është kjo buka e kungimit që ka qenë shndërruar, me fjalët e t'Ynë Zoti dhe me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, në kurmin e Krishtit. Siç thotë fjala greke *antidoron*, kjo bukë jepet « në vend të kungimit », por s'është euharistia e shenjtë.

Kjo bukë vetëm e bekuar gjatë meshës u jepet atyre që nuk mund të qasen në kungim; mund t'u çohet edhe në shtëpi atyre që nuk shkojnë në kishë dhe të sëmurëve.

113. I riu: *Në kishën bizantine përdoret vetëm Liturgjia e Shën Joan Hrysostomit?*

Prifti: Jo. Përdoren edhe: Liturgjia e Shën Vasilit, Liturgjia e Shën Japkut, dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarve.

114. I riu: *Kur përdoret Liturgjia e Shën Vasilit?*

Prifti: Kjo Liturgji merr emrin nga Shën Vasili i Madh i cili shkroi anaforën e saj. Është pak më e gjatë dhe shumë e bukur. Ka të njëjtën strukturë me atë të Shën Joan Hrysostomit. Kjo liturgji përdoret vetëm 10 herë në vit: në të gjitha të dielat e Kreshmës, të Enjten dhe të Shtunën e Madhe, në vigjiljet e Krishtlindjes dhe të Epifa-

112. Il giovane: *Perché al termine della liturgia si distribuisce il pane benedetto?*

Il sacerdote: Questo pane si chiama « antidoron ». È pane soltanto benedetto. Non è questo il pane della comunione che, per le parole di Nostro Signore Gesù Cristo e con la potenza dello Spirito Santo, è stato trasformato in corpo di Cristo.

Così come dice il termine greco *antidoron*, questo pane si dà « al posto » della comunione, ma non è la santa eucarestia.

Questo pane invece, soltanto benedetto durante la messa, si può dare a coloro che non sono in grado di accostarsi alla comunione. Può essere portato anche a casa a coloro che non sono andati in chiesa e agli ammalati.

113. Il giovane: *Nella chiesa bizantina si usa solamente la liturgia di S. Giovanni Crisostomo?*

Il sacerdote: No. Si usa anche la liturgia di S. Basilio, la liturgia di S. Giacomo, la liturgia dei Presantificati.

114. Il giovane: *Quando si usa la liturgia di S. Basilio?*

Il sacerdote: Questa liturgia prende il nome da S. Basilio il Grande, il quale ha redatto la parte anaforica di essa.

È una liturgia alquanto più lunga e molto bella. Ha l'identica struttura di quella di S. Giovanni Crisostomo.

Essa si usa soltanto dieci volte l'anno: nelle domeniche di quaresima, il giovedì e il sabato della Settimana Santa, le vigilie di Na-

nisë, dhe në festën e Shën Vasilit të Madh (1 Janar).

115. I riu: *Po liturgjia e Shën Japkut kur celebrohet?*

Prifti: Kjo liturgji merr emrin nga apostulli sh. Japku, i cili thuhet se e organizoi. Ka një strukturë të veçantë. Mund të celebrohet ditën e festës së Shën Japkut (23 tetor).

116. I riu: *Ç' është liturgjia e të parashenjtëruarve?*

Prifti: Të mërkurat dhe të premtet e Kreshmës, mbrëmanet, bëhet Liturgjia e të Parashenjtëruarve.

Kjo nuk është meshë, por një ceremoni e lidhur me lutjet e mbrëmjes, gjatë së cilës shpërndahet kungimi me dhuratat e shenjtëruara në meshën e së dielës së kaluar. Prandaj quhet Liturgjia e të Parashenjtëruarve. Në kohën e Kreshmës liturgjia euharistike celebrohet vetëm të shtunën dhe të dielën, dhe në festën e Evangjelizmit (25 mars).

117. I riu: *Ç' vend zë mesha në kishën bizantine?*

Prifti: Për kishën bizantine euharistia zë vendin qendror. Kështu është edhe për kishën latine dhe për të krishterët e tjerë. Euharistia e bën kishën, i jep formë dhe e rrit. Ajo mbledh të krishterët që kungohen në kurmin e Krishtit dhe bashkon kështu komunitetin. Ky është bashkimi i vërtetë i të krishterëve, domethënë kisha e krishterë, që quhet edhe trupi mistik i Krishtit.

tale e dell'Epifania e per la festa di S. Basilio il Grande (1 gennaio).

115. Il giovane: *Quando si celebra la liturgia di S. Giacomo?*

Il sacerdote: Questa liturgia prende il nome dall'apostolo S. Giacomo, il quale l'avrebbe organizzata. Essa ha una struttura propria. Si può celebrarla il giorno della festa di S. Giacomo (23 ottobre).

116. Il giovane: *Cosa è la liturgia dei Presantificati?*

Il sacerdote: Il mercoledì e il venerdì di quaresima, la sera, si celebra la liturgia dei Presantificati. Questa non è una vera e propria liturgia eucaristica ma una celebrazione che collega il vespro e la distribuzione della comunione con i sacri doni consacrati la domenica precedente. Per questo si chiama Liturgia dei Presantificati.

Durante la quaresima la liturgia eucaristica si celebra soltanto il sabato e la domenica, e il giorno dell'Annunciazione (25 marzo).

117. Il giovane: *Che posto ha la celebrazione eucaristica nella chiesa bizantina?*

Il sacerdote: Per la chiesa bizantina l'eucarestia ha un posto centrale. Ugualmente è per la chiesa latina e anche per gli altri cristiani. L'eucarestia fa la chiesa, le dà forma e la fa crescere. Essa raccoglie i cristiani che si comunicano al corpo di Cristo e in tal modo unisce la comunità. È questa la vera comunità dei cristiani, cioè la chiesa cristiana, che si chiama anche Corpo mistico di Cristo.

Celebrimi i meshës është shprehja më e plotë dhe më e lartë e kishës. Pra mesha që thotë peshkopi është simboli i kishës lokale dhe i njësisë së saj. Te kjo meshë gjithsecili ka vendin e tij: peshkopi, priftërinjtë, dhjakët dhe laikët, burrat e gratë. Të gjithë bashkë përbëjnë kishën lokale, kishën e atij vendi, të organizuar në ministret e ndryshëm që Shpirti i Shenjtë i jep kujtdo për të mirën e të gjithëve.

118. I riu: *Ekzistojnë celebrime të tjera në liturgjinë bizantine?*

Prifti: Ka celebrime të veçanta në shumë festa dhe për çdo ditë. Kështu nga ditë këndohen lutjet e mëngjesit dhe mbrëmëso-rja. Këto celebrime janë më të pasura në vigjiljet e festave. Pastaj në disa festa këndohen lutjet e Orëve të Mëdha, kështu për Krishtlindjen, për Epifaninë, për të premtën e madhe.

Java e Madhe është e organizuar me rite shumë të bukura dhe të pasura. Për Epifaninë bekohet uji dhe pastaj prifti shkon shtëpi më shtëpi për t'i bekuar.

Ditën e Pentekostes i bëhen lutje të veçanta Shpirtit të Shenjtë. Në të parat dy javë të gushtit këndohet për shën Mërinë lutja e Paraklisës dhe gjatë kreshmës Akathisti. Për të vdekurit këndohet Trishenjtë çdo herë që dikush ia lyp priftit.

119. I riu: *Ç'është Trishenjtë për të vdekurit?*

Prifti: Është lutja që në kishën bizantine përdoret për të vdekurit, jo vetëm ditën kur

La celebrazione della eucarestia è l'espressione più piena e più alta della chiesa.

La messa presieduta dal vescovo esprime la chiesa locale e la sua unità. In questa celebrazione ciascuno ha il proprio posto: il vescovo, i sacerdoti, i diaconi e i laici, uomini e donne. Tutti insieme costituiscono la chiesa locale, la chiesa di un dato luogo, organizzata nei vari ministeri che lo Spirito Santo dà a ciascuno per il bene di tutti.

118. Il giovane: *Esistono altre celebrazioni nella liturgia bizantina?*

Il sacerdote: Ci sono celebrazioni speciali per molte feste e per ciascun giorno, in modo particolare il Vespro e l'Orthros. Queste celebrazioni sono più ricche per le vigilie delle feste. Per alcune feste si recitano le Grandi Ore, così per Natale, per l'Epifania, per il venerdì santo. La settimana santa è organizzata con riti molto significativi. Per l'Epifania si fa la benedizione delle acque e il sacerdote passa di casa in casa per benedirle.

Nel giorno di Pentecoste si recitano particolari preghiere allo Spirito Santo. Nelle prime due settimane di agosto si canta la *Paraklisis* alla Theotokos e durante la quaresima l'*Akathistos*. Per i defunti si canta il *Trisaghion* ogni volta che qualcuno ne fa richiesta.

119. Il giovane: *Cosa è il Trisaghion per i defunti?*

Il sacerdote: Il Trisaghion è la preghiera per i defunti, non soltanto in occasione della

dikush vdes, por edhe në raste të tjera. Kjo lutje mund të bëhet çdo herë që ndokush e do.

Me këtë lutje kisha i lyp Perëndisë që t'i falë të vdekurit të gjitha mëkatet, ta pastrojë nga çdo njollë dhe ta preh në vendin e dritës, në tendat e të drejtëve, atje ku s'ka as dhimbje as psherëtim. Në këtë mënyrë të gjallët mund të ndihmojnë të vdekurit para Perëndisë.

120. I riu: *Ç' rol kanë ikonat në kishën bizantine?*

Prifti: Në kishën bizantine ikonat kanë një rol jo vetëm artistik e pedagogjik, por veçanërisht liturgjik.

Ato janë pjesë përbërëse e liturgjisë dhe simbolizojnë njerëzinë e re, të shndërruar në shëmbëllesën dhe në përgjasimin e Perëndisë.

Ikonostasi është një karakteristikë arkitektonike që del para sysh. Atje ikonat përkujtojnë të vërtetat themelore të besës së krishterë.

Në kishat bizantine nuk përdoren statujat.

morte di qualcuno, ma anche in altre circostanze. Lo si può chiedere ogni volta che si vuole.

Con questa preghiera la chiesa chiede a Dio che al defunto perdoni tutti i peccati, lo purifichi da ogni macchia e lo accolga nel luogo della luce, dove riposano i giusti, là dove non vi è dolore, né pianto. In questa maniera i vivi possono aiutare i defunti di fronte al Signore.

120. Il giovane: *Quale ruolo hanno le icone nella chiesa bizantina?*

Il sacerdote: Nella chiesa bizantina, le icone hanno un ruolo non solo artistico e pedagogico, ma anche particolarmente liturgico.

Esse sono parte costitutiva della liturgia e simboleggiano l'umanità nuova, trasfigurata a immagine e somiglianza di Dio. L'iconostasi è una caratteristica architettonica ben visibile. Lì, le icone ricordano le verità fondamentali della fede cristiana.

Nelle chiese bizantine non si usano statue.

121. I riu: *Ç'është viti liturgjik?*

Prifti: Kisha e ka organizuar vitin në shumë festa, në mënyrë që të përkujtohet çdo vit e tërë jeta e Zotit Krisht: Krishtlindja, pagëzimi (Epifania), vdekja (java e madhe), ringjallja (Pashkët), ngjitja në qiell, ardhja e Shpirtit të Shenjtë (Pentekostja). Celebrohet kështu vepra e shpëtimit.

Gjatë vitit përkujtohen edhe festat e Shën Mërisë dhe të gjithë Shenjtorëve.

Viti i organizuar kështu quhet vit liturgjik.

122. I riu: *Pse kisha e organizoi kështu vitin e saj?*

Prifti: Kisha e bëri këtë që të kujtojë çdo vit ato që Zoti Krisht bëri për të mirën e njerëzve, që të përkujtojë ata që ruajtën Fjalën e t'Ynë Zoti dhe u bënë shenjtorë. Kisha kështu kërkon të mësojë të krishterët në besën.

Kisha ka organizuar kështu vitin para së gjithash për të lavdëruar Perëndinë.

123. I riu: *Kur zë fill viti liturgjik?*

Prifti: Ditën e Pashkëve. Pashkët janë qendra e liturgjisë. Ajo është festa e festave, dita e shpëtimit të njeriut, sepse në atë ditë u ngjall Zoti Krisht. Duke u ringjallur nga të vdekurit Krishti e mudi vdekjen dhe i

121. Il giovane: *Cosa è l'anno liturgico?*

Il sacerdote: La chiesa ha istituito molte feste per l'intero anno, in modo che in ogni anno si commemori l'intera vita di nostro Signore Gesù Cristo: il Natale, il battesimo (Epifania), la morte (settimana santa), la resurrezione (Pasqua), l'Ascensione, la venuta dello Spirito Santo (Pentecoste). Durante l'anno si fa anche memoria delle feste della Madre di Dio e di tutti i Santi.

L'anno così organizzato si dice anno liturgico.

122. Il giovane: *Perché la chiesa ha organizzato così l'anno?*

Il sacerdote: La chiesa ha fatto questo perché ci si ricordi sempre di tutto ciò che Nostro Signore Gesù Cristo ha fatto in favore degli uomini, perché ci si ricordi di tutti coloro che hanno messo in pratica la Parola di Dio e sono diventati santi. In tal modo la chiesa cerca di insegnare ai cristiani la fede.

La chiesa ha fatto questo innanzitutto per dare gloria a Dio.

123. Il giovane: *Quando ha inizio l'anno liturgico?*

Il sacerdote: Il giorno di Pasqua. La Pasqua è il centro della liturgia. È la festa delle feste, il giorno della salvezza dell'uomo, perché in quel giorno è risuscitato Nostro

dha njeriut një jetë të re. Është kjo besa e vërtetë e të krishterit.

Nga Pashkët zë fill viti liturgjik. Të djelat nisin një cikël që nga një Pashkë të çon te tjetra festë e Pashkëve. Dhe në çdo të diel përkujtohet ringjallja e t'Ynë Zoti.

Nga dita e Pashkëve zë fill të lexohet libri i Vangjejeve, Aktet dhe Letrat e apostujve. Nga dita e Pashkëve varen shumë festa si për shembull: ngjitja e Krishtit në qiell, ardhja e Shpirtit të Shenjtë (Pentekostja), festa e të gjithë Shenjtorëve, përkujtimi i të vdekurve, pentekostari dhe kreshma. Të gjitha këto festa varen nga Pashkët, të cilat nuk bien gjithmonë tek e njëjta ditë, po ndërrojnë nga viti në vit.

Prandaj edhe këto festa ndërrojnë ditë.

124. I riu: *Ka edhe festa në datë të pandryshueshme?*

Prifti: Po. Për shembull: Krishtlindja (25 dhjetor), Epifania (6 janar), Evangjelizmi (25 mars), Vdekja e shën Mërisë dhe ngjitja e saj në qiell (15 gusht), festa e Kryqit të Shenjtë (14 shtator), dhe të gjitha festat e Shenjtorëve.

125. I riu: *Kur kremtohen festat e Shenjtorëve?*

Prifti: Çdo ditë kisha përkujton një o më shumë shenjtorë. Kisha i propozon si shembuj, që të rrojmë edhe ne si ata, në udhën e drejtë të t'Ynë Zoti.

Signore Gesù Cristo. Risorgendo dai morti, Gesù Cristo ha sconfitto la morte e ha dato all'uomo una vita nuova. È questa la vera fede dei cristiani.

Dalla Pasqua incomincia l'anno liturgico. Lì inizia il ciclo delle domeniche che da una Pasqua porta all'altra. E ogni domenica si celebra la resurrezione di Nostro Signore. Dal giorno di Pasqua ha inizio l'Evangelario e la lettura degli Atti e delle Lettere degli apostoli.

Dal giorno di Pasqua dipendono molte feste, come per esempio: l'Ascensione di Nostro Signore Gesù Cristo, la Pentecoste, la festa di tutti i Santi, la commemorazione dei defunti, il tempo del pentekostarion, la quaresima. Tutte queste feste dipendono dalla Pasqua, la quale non si celebra sempre nello stesso giorno, ma cambia data ogni anno. Di conseguenza queste sono mobili.

124. Il giovane: *Ci sono anche delle feste in date fisse?*

Il sacerdote: Sì. Per esempio: il Natale (25 dicembre), l'Epifania (6 gennaio), l'Annunciazione (25 marzo), la morte e l'Assunzione al cielo della Madre di Dio (15 agosto), la festa della Santa Croce (14 settembre) e tutte le feste dei Santi.

125. Il giovane: *Quando si celebrano le feste dei Santi?*

Il sacerdote: Ogni giorno la chiesa fa memoria di uno o più Santi. Essi ci sono proposti come esempio da imitare, perché viviamo anche noi come loro, sulla retta via

Këto festa janë të caktuara për çdo ditë në një kalendar që në kishën bizantine nis të parën ditë të muajit shtator.

126. I riu: *Kisha arbëreshe dhe kisha lëtire a kanë të njëjtin kalendar liturgjik?*

Prifti: Jo. Kisha arbëreshe mban kalendarin bizantin, kurse kisha lëtire mban kalendarin romak. Por festat më të mëdha janë të njëjta, si Pashkët, java e madhe, ngjitja në qiell e Zotit tonë Jezu Krishtit, ardhja e Shpirtit të Shenjtë, Pentekostja, Krishtlindja, Epifania, ngjitja në qiell e shën Mërisë. Po ashtu është edhe për shumë festa të Shenjtorëve.

127. I riu: *Kisha arbëreshe dhe kisha ortodokse a kanë të njëjtin kalendar?*

Prifti: Ne arbëreshët përdorim në kishat tona të gjithë librat liturgjikë të ortodoksëve. Edhe viti liturgjik është i njëjtë. Por ortodoksët nuk e kanë pranuar reformën e kalendarit që, me ndihmën e astronomit kalabrez Luigi Giglio, ka bërë Papa Gregori XIII (1582). Kështu ortodoksët e matin, edhe sot, ditën e Pashkëve me kalendarin e vjetër të perandorit romak Jul Cezarit. Shumë herë Pashkët nuk bien në të njëjtën ditë. Për këtë edhe të gjitha festat që varen nga Pashkët përkujtohen në ditë të ndryshme nga ato në të cilat i përkujtojmë ne arbëreshët që morëm kalendarin e ri gregorian.

di Nostro Signore Gesù Cristo. Queste feste sono stabilite per ciascun giorno, in un calendario che nella chiesa bizantina incomincia il 1 di settembre.

126. Il giovane: *La chiesa arbëreshe e la chiesa latina hanno lo stesso calendario liturgico?*

Il sacerdote: No. La chiesa arbëreshe segue il calendario bizantino, mentre la chiesa latina quello romano. Ma le feste maggiori sono identiche, come la Pasqua, la settimana santa, l'Ascensione di Nostro Signore Gesù Cristo, la venuta dello Spirito Santo (Pentecoste), il Natale, l'Epifania, l'Assunzione al cielo della Madre di Dio. Ugualmente è per molte feste dei Santi.

127. Il giovane: *La chiesa arbëreshe e la chiesa ortodossa seguono lo stesso calendario?*

Il sacerdote: Noi arbëreshë usiamo nelle nostre chiese tutti i libri liturgici degli ortodossi. Anche l'anno liturgico è lo stesso. Ma gli ortodossi non hanno accettato la riforma del calendario, che, con l'aiuto dell'astronomo calabrese Luigi Giglio, ha effettuato Papa Gregorio XIII (1582). Di conseguenza gli ortodossi determinano, ancora oggi, il giorno di Pasqua in base al vecchio calendario dell'imperatore romano Giulio Cesare. Spesso la Pasqua non cade nello stesso giorno. Pertanto tutte le feste dipendenti dalla Pasqua si celebrano in giorni diversi da quelli in cui le celebriamo noi arbëreshë, che abbiamo assunto il nuovo calendario gregoriano.

128. I riu: *Pse nuk bëhet një marrëveshje kështu që të gjithë të krishterët t'i kremtojnë Pashkët së bashku?*

Prifti: Do t'ishte shumë mirë. Janë bërë disa përpjekje për të arritur një marrëveshje të tillë, por të krishterët janë ende të ndarë për problemin e ditës së Pashkëve.

129. I riu: *Pse përsëriten çdo vit të njëjtat festa?*

Prifti: Që njeriu të mësojë, duhet t'i përsëriten të njëjtat mësimet. Ne nuk mundemi të kuptojmë gjithçka në tërësi një herë. Nga ana tjetër misteri i krishterë është tepër i madh dhe i vështirë të kuptohet plotësisht.

Kisha, si mëmë që i do me zemër fëmijët, na i përsërit mësimet. Prandaj çdo vit, në Pashkë, dhe çdo të diel, kisha na kujton vdekjen dhe ngjalljen e Krishtit. Çdo ditë na thotë se njerëzit dëgjuan Vangjelin, dhe disa u bënë shenjtorë. Kjo do të thotë se edhe ti duhet të jesh i shenjtë, njeri i ri në këtë jetë. Dhe se kjo gjë është krejt e mundshme.

Në këtë mënyrë shenjtërohet koha.

128. Il giovane: *Perché non si fa un accordo in modo che tutti i cristiani celebrino Pasqua insieme?*

Il sacerdote: Sarebbe auspicabile. Ci sono stati dei tentativi per raggiungere un tale accordo, ma i cristiani sono ancora divisi sul computo del giorno di Pasqua.

129. Il giovane: *Perché si ripetono ogni anno le stesse feste?*

Il sacerdote: Perché l'uomo impari, occorre che si ripetano gli stessi insegnamenti. Noi non possiamo comprendere completamente tutto in una volta sola.

D'altronde il mistero cristiano è molto grande e difficile da capire pienamente. La chiesa, come madre che ama i propri figli, ci ripete gli insegnamenti. Per questo ogni anno, a Pasqua, e ogni domenica, la chiesa fa memoria della morte e della resurrezione di Cristo. Ogni giorno ci dice che alcuni hanno ascoltato l'Evangelo e sono diventati santi. Questo significa che anche tu devi essere santo, uomo nuovo in questo mondo. E che ciò è possibile.

In questo modo viene santificato il tempo.